



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 30/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Time Kadriaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.01.2011, nga subjekti politik LVV, në të cilën pretendohet se në Carrabreg komuna e Deçanit, kandidatja për deputete e AAK Time Kadriaj ka votuar në mënyrë të rregullt në shkollën Lidhja e Prizrenit QV 0101x në vendvotimin 01R rreth orës 10:00. Ndërkaq kandidatja në fjalë po ashtu edhe në emër të Tabe Kadriaj në shkollën fillore Gramaqel QV 0103c vendvotimi 02R rreth orës 15:00.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Për te vërtetuar faktin e pretenduar nga parashtruesi i ankesës PZAP analizoi dhe hetoi materialin zgjedhor, përkatësisht listat e votuesve për VV 0103C/02R dhe VV 0101X/01R. Pasi PZAP krahasoj nënshkrimin e votueses Tabe Kadriaj që gjendet në listën e votuesve për VV 0103C/02R me nënshkrimin e votueses Time Kadriaj në VV 0101X/01R, nuk konstatoj se të dy nënshkrimet ishin identike dhe si rrjedhim nuk gjeti prova për te vërtetuar shkeljen e pretenduar dhe për këtë arsye vlerësoi se pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 30/2011 më datën 13.01.2011.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

